



**QKSS**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

# RISHIKIM PARAPRAK I ZBATIMIT TË POLITIKAVE PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE NË KOSOVË:

## CILAT JANË SFIDAT KYÇE TË HARTIMIT DHE ZBATIMIT TË TYRE?



Prill 2024

**Autor:** Alban Dafa

**Editor:** Mentor Vrajolli

## **Rreth Programit të Integritetit dhe të Sundimit të Ligjit**

Programi i Integritetit dhe i Sundimit të Ligjit është zhvilluar për të përballuar sfidat ekzistuese dhe të reja brenda sektorit të sigurisë në Kosovë. Qëllimi kryesor është të promovojë sundimin e ligjit, përfshirjen, llogaridhënien dhe mbikëqyrjen parlamentare për të siguruar një kuadër të sigurisë më demokratik dhe transparent.

Kjo nismë do të përqendrohet në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, në forcimin e integritetit dhe në integrimin e komuniteteve jo-shumicë përmes intervenimeve të synuara. Gjithashtu, synon të përmirësojë aftësitë parlamentare për një mbikëqyrje efektive dhe të nxisë një dialog konstruktiv midis shoqërisë civile dhe institucioneve të sigurisë.

Fushta kryesore të programit përfshijnë mbështetjen për përmirësimin e kuadrit ligjor, angazhimin e komunitetit, zhvillimin e politikave dhe avokimin për masat kundër korrupsionit. Përmes këtyre përpjekjeve,

QKSS do të shfrytëzojë ekspertizën dhe rrjetet e saj për të përputhur me prioritetet kombëtare dhe standardet ndërkombëtare, duke kontribuar ndjeshëm në paqen, stabilitetin dhe zhvillimin e Kosovës.

Programi do të zhvillohet përmes: Mbështetjes së forcimit të kuadrove ligjore dhe institucionale për të mbrojtur sundimin e ligjit dhe për të luftuar korrupsionin. Avokimit për strategjitë përfshirëse të rekrutimit dhe angazhimit të komunitetit për të integruar komunitetet jo-shumicë. Përmirësimin të mbikëqyrjes parlamentare përmes këshillave politike për procedura dhe kuadre ligjore të përmirësuara. Promovimit të dialogut dhe bashkëpunimit midis shoqërisë civile dhe institucioneve të sigurisë për të rritur transparencën dhe besimin publik.

Për më shumë informata rreth këtij programi mund të na kontaktoni në: [integrity@qkss.org](mailto:integrity@qkss.org)



**QKSS**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

# **RISHIKIM PARAPRAK I ZBATIMIT TË POLITIKAVE PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE NË KOSOVË:**

**Cilat janë sfidat kyçe të hartimit dhe zbatimit të tyre?**

# Përmbajtja

<b>HYRJE</b>	<b>1</b>
<b>KOORDINIMI I POLITIKAVE TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE</b>	<b>3</b>
Koordinimi ndërinstytucional	3
Dokumentet kyçe të politikave dhe ndërlidhja e tyre	6
<b>KUADRI RREGULLATOR DHE MBIKËQYRJA</b>	<b>9</b>
Përgjegjësitë e mbikëqyrjes	9
Mangësitë e mekanizmave të mbikëqyrjes	12
<b>ZBATIMI I MASAVE PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE</b>	<b>14</b>
<b>PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME</b>	<b>19</b>

# HYRJE

Pastrimi i parave është një fazë thelbësore e ciklit të krimit, pasi mundëson rifutjen dhe ripërdorimin e parave të fituara në mënyrë të jashtëligjshme në ekonominë e ligjshme. Kësisoj, politikat për parandalimin e pastrimit të parave të fituara në mënyrë të jashtëligjshme përbëjnë një prej mekanizmave kyç të parandalimit të krimit dhe korrupsionit.

Kosova ka bërë hapa të rëndësishme në hartimin e politikave të parandalimit të pastrimit të parave, ngritjen e infrastrukturës institucionale për këtë qëllim, si dhe zbatimin e masave për të identifikuar prirjet e pastrimit të parave dhe për të parandaluar riqarkullimin e parasë të fituar në mënyrë të jashtëligjshme. Pas miratimit të Ligjit për Parandalimin dhe Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit<sup>1</sup> (më tutje “Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave”) në vitin 2016, Njësia e Inteligjencës Financiare, Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit, Dogana e Kosovës, Adminsitrata Tatimore e Kosovës dhe institucione të tjera të sundimit të ligjit e kanë rritur bashkëpunimin për identifikimin, hetimin dhe ndëshkimin e rasteve të pastrimit të parave.

Në këto përpjekje, Kosova është duke u ndihmuar me ekspertizë prej programit PECK (Project against Economic Crime in Kosovo) III të Këshillit të Evropës dhe programit SAEK (Support to Anti-Corruption Efforts in Kosovo) të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Ndihma e tyre shtrihet prej ofrimit të trajnimeve tematike deri te ofrimi i asistencës teknike për hartimin e dokumenteve teknike – p.sh. për vlerësimet e riskut dhe tipologjive të pastrimit të parave – dhe strategjike – p.sh. *Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023* (më tutje “Strategjia”)<sup>2</sup>.

Një prej qëllimeve specifike të Strategjisë është edhe ndërgjegjësimi i shoqërisë civile për rrezikun për sigurinë dhe mirëqënien që paraqet pastrimi i parave. E megjithatë, duket se ndërgjegjësimi i shoqërisë civile është parë kryesisht i lidhur me mospranimin dhe denoncimin e dukurisë së pastrimit të parave prej saj. Rrjedhimisht, ka pak ose aspak angazhim nga shoqëria civile në monitorimin dhe vlerësimin e përpjekjeve për ngritjen e mekanizmave ligjore dhe institucionale për të parandaluar pastrimin e parave.

Kontributi i shoqërisë civile në këtë fushë të politikave publike nuk duhet të jetë ndryshe prej angazhimeve të shoqërisë civile në politikat e parandalimit të korrupsionit dhe integritetit të administratës publike. Ashtu sikurse kërkon llogari dhe efektshmëri për hartimin dhe zbatimin e politikave të sundimit të ligjit dhe parandalimit të korrupsionit, shoqëria civile duhet të kërkojë llogari dhe të ndihmojë përpjekjet për hartimin dhe zbatimin e efektshëm të politikave të parandalimit të pastrimit të parave.

Roli i shoqërisë civile në këtë drejtim bëhet edhe më i rëndësishëm duke qenë se prej vitit

1 Ligji Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540>

2 Ministria e Financave, *Strategjia Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023* (Prishtinë: Ministria e Financave, 2019), <https://mfpt.rks-gov.net/>.

2018 nuk ka patur monitorim dhe vlerësim të pavarur të politikave të parandalimit të pastrimit të parave.<sup>3</sup> Ky punim synon kryejë një vlerësim paraprak të këtyre politikave. Ai nuk synon të vlerësojë efektshmërinë apo suksesin e tyre, por të identifikojë probleme të cilat lidhen me (i) koordinimin ndërinstitucional, (ii) koherencën e politikave të shprehura në kuadrin rregullator, si dhe (iii) zbatimin e masave të parandalimit të pastrimit të parave. Përzgjedhje e këtyre çështjeve bazohet në tërësi mbi rekomandimet e FATF (*Financial Action Task Force* ose Grupi i Punës për Veprimin Financiar)<sup>4</sup>, por qëllimi i punimit është më tepër të ofrojë një pamje të përgjithshme të zhvillimeve në këtë fushë politikash se sa të kryejë një vlerësim rigoroz mbi përthpueshmërinë e masave të marra nga institucionet e Kosovës për përmbushjen e rekomandimeve të FATF. Hulumtimi për këtë punim mbështetet në rishikimin e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave, raportet të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, raportet dhe të dhënat e institucioneve publike të Kosovës, si dhe mbi intervistat e kryera me përfaqësues të shoqatave profesionale të subjekteve ekonomike të cilat kanë detyrime për raportimet e veprimtarive financiare të dyshimta. Punimi përmbillet me disa rekomandime për t'u marrë në konsideratë prej institucioneve përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave të parandalimit të pastrimit të parave.

---

3 Në 2018 është kryer një vlerësim tërësor për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë në kuadër të projektit PECK II. Shih Project against Economic Crime II. Shih Council of Europe, "Assessment report on compliance of Kosovo with international anti-money laundering and combating the financing of terrorism standards", <https://rm.coe.int/assessment-report-on-compliance-of-kosovo-with-international-anti-mone/16809381e1>.

4 Për më tepër, shih FATF, "FATF Recommendations," qasur së fundmi në 25 nëntor 2023, <https://www.fatf-gafi.org/en/topics/fatf-recommendations.html>.

# KOORDINIMI I POLITIKAVE TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

Parandalimi i pastrimit të parave është një proces kompleks që kërkon një ndërveprim operacional dinamik. Përcaktimi i detyrave të qarta institucionale, ndërtimi i mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional e ndërkombëtar për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit, si dhe hartimi i politikave që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të trajtimit të problematikës janë tejet të rëndësishëm për të patur politika të suksesshme për parandalimin e pastrimit të parave. Detyrimet institucionale për zbatimin e këtyre politikave rrjedhin kryesisht prej Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe prej Strategjisë. Megjithatë, duket se në disa raste ka mbivendosje të detyrave, ndërkohë që struktura e llogaridhënies është disi e paqartë.

## Koordinimi ndërinstitucional

Politikat e parandalimit të pastrimit të parave në Republikën e Kosovës rregullohen nëpërmjet Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Ligji përfshin, ndër të tjera, dispozita të cilat përcaktojnë detyrimet institucionale për të bashkëpunuar në hartimin e politikave të parandalimit e pastrimit të parave. Specifikisht, neni 6 (1.7) përcakton se **Bordi Mbikëqyrës i Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës (NJIF-K) funksionon si mekanizmi përgjegjës koordinues për përcaktimin e orientimin e politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit**. Bordi Mbikëqyrës udhëhiqet nga ministri i Financave dhe anëtarët e tij përfshijnë ministrin e Punëve të Brendshme, kryeprokurorin e Shtetit, drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës, drejtorin e përgjithshëm të Doganave dhe guvernatorin e Bankës Qëndrore të Kosovës.

Bordi duhet të mbidhet të paktën dy herë në vit për të kryer detyrimet e tij ligjore, të cilat – përpos koordinimit të politikave shtetërore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit – përfshijnë emërimin dhe shkarkimin e drejtorit të NJIF-K, miratimin e rregullores së brendshme të insitucionit dhe kontrollin dhe mbikëqyrjen e performancës së drejtorit dhe të institucionit. Për të përmbushur detyrimet ligjore për koordinimin e politikave, Bordi ka të drejtë të ngrejë grupe pune për të trajtuar çështje specifike lidhur me politikat e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.<sup>5</sup> Në shtator 2020 Bordi ka miratuar ngritjen e Grupit Punues “për të bashkërenduar aktivitetet në fushën e politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe për të përcaktuar përparësitë strategjike afatgjata dhe afatshkurtra”<sup>6</sup>. Qëllimi i këtij grupi punues duket tejet i gjerë, ndërkohë që detyrat e tij specifike, procesi i koordinimit ndërinstitucional mes anëtarëve, si dhe politikat specifike që duhet të prodhohen prej punës së kryer nuk janë të përcaktuara në vendimin e posaçëm të Qeverisë së Kosovës.

5 Neni 6 (1.8), Ligji Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

6 Informacion i dhënë nga Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës nëpërmjet postës elektronike në datën 18 shtator 2023 në përgjigje të një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

Përpos detyrave të Bordit Mbikëqyrës të NJIF-K, të cilat janë të përcaktuara me ligj, Strategjia përcakton gjithashtu një mekanizëm ndërinstucional për koordinimin e zbatimit të politikave për parandalimin dhe luftimin e krimit ekonomik, ekonominë jo-formale, si dhe për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Duke marrë parasysh që Strategjia e tejkalon qëllimin e parandalimit të pastrimit të parave, konfigurimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tij ndryshon prej atij të Bordit Mbikëqyrës të NJIF-K. Koordinimi ndërinstucional për të përmbushur këto detyrime ndahet në nivelin politik dhe atë teknik.

Në nivelin politik, Grupi Qeveritar Punues (GQP) është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë. Ashtu sikurse Bordi Mbikëqyrës i NJIF-K, GQP kryesohet nga ministri i Financave. Anëtarët e tjerë përfshijnë ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ministrin e Drejtësisë, ministrin e Punëve të Brendshme, ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës, drejtorin e përgjithshëm të Doganave, kryeprokurorin i Shtetit, guvernatorin e Bankës Qëndrore të Kosovës, kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, drejtorin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe drejtorin e NJIF-K.<sup>7</sup>

GQP duhet të mblidhet të paktën dy herë në vit dhe puna e kësaj strukture ndihmohet prej Sekretariatit, i cili ka një përbërje të ngjashme institucionale (shih Tabelen 1 më poshtë për një pamje më të qartë të ngjashmërisë në përbërjen institucionale). Sekretariati udhëhiqet nga një përfaqësues i ministrisë së Financave, por nuk ka në përbërje të tij përfaqësues të ministrisë së Punëve të Brendshme, Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit. Përkundër, Sekretariati përfshin përfaqësues prej institucioneve të cilat nuk janë pjesë e GQP. Ato përfshijnë përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit, ministrisë për Integrim Evropian (ministra e Punëve të Jashtme dhe Diasporës) dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Pjesë e Sekretariatit është edhe Koordinatori Kombëtar kundër Krimit Ekonomik, i cili është pjesë e Këshillit Prokurorial të Kosovës.<sup>8</sup>

**Tabela 1** Përbërja institucionale e Bordit Mbikëqyrës të NJIF-K, GQP dhe Sekretariatit të GQP

BORDI MBIKËQYRËS I NJIF-K	GQP	SEKRETARIATI I GQP
Ministri i Financave	Ministri i Financave	Ministria e Financave

7 Ministria e Financave, Punës dhe Transferave, *Strategjia Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023*, 26-27.

8 Ministria e Financave, Punës dhe Transferave, *Strategjia Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023*, 27-28.

BORDI MBIKËQYRËS I NJIF-K	GQP	SEKRETARIATI I GQP
Ministri i Punëve të Brendshme	Ministri i Punëve të Brendshme	Zyra e Kryeministrit
Kryeprokurori i Shtetit	Kryeprokurori i Shtetit	Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës	Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës	Policia e Kosovës
Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës	Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës	Administrata Tatimore e Kosovës
Drejtori i Përgjithshëm i Doganave	Drejtori i Përgjithshëm i Doganave	Dogana e Kosovës
Guvernatorin i Bankës Qendrore të Kosovës	Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës	Banka Qendrore e Kosovës
	Ministri i Tregtisë dhe Industrisë	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
	Ministri i Drejtësisë	Ministria e Drejtësisë
	Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
	Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës	Ministria për Integrim Evropian (e Punëve të Jashtme dhe Diasporës)
	Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
	Drejtori i Njesisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës	Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës

Puna e këtyre strukturave koordinuese bëhet e vështirë për t'u vlerësuar për shkak të mungesës së objektivave të qarta politike, detyrave specifike institucionale, si dhe detyrimeve për koordinimin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave. Është krejtësisht e paqartë mënyra se si Bordi Mbiqëqyrës i NJIF duhet të koordinojë punën me GQP dhe Sekretariatit. Bordi dhe detyrimi i tij ligjor për të koordinuar **përcaktimin e orientimin e politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit** nuk përmenden. Strategjia përmban pak udhëzime për mënyrën e funksionimit të GQP dhe Sekretariatit. Për më tepër, duket se nuk ka akte të tjera rregullatore që përcaktojnë mënyrën e funksionimit të këtyre

organeve dhe përgjegjësitë specifike të secilit institucion dhe përfaqësuesve të tyre.<sup>9</sup>

Këto mungese lënë të kuptohet ka një mundësi të lartë që bashkërendimi i politikave nuk bëhet nëpërmjet një forumi të qëndrueshëm. Kjo përshtypje konfirmohet më tej nëpërmjet përgjigjeve prej ministrisë së Financave. Në përgjigje të një kërkesë për të përfutur procesverbalet e takimeve të Sekretariatit, përfaqësuesit e ministrisë së Financave ndanë procesverbalet e takimeve dypalëshe të tyre me disa institucione – përkatësisht, me Inspektoriatin e Punës, ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorin e Shtetit – por jo takime të përbashkëta të Sekretariatit për të diskutuar ecurinë e Strategjisë dhe për të hartuar e miratuar raportet e monitorimit të zbatimit të tij.<sup>10</sup> Kjo nuk është thjesht një vërejtje procedurale; përkundrazi, mungesa e takimeve të përbashkëta – dhe kryerja e takimeve dypalëshe në vend të tyre – lë të kuptojë se ndërveprimi institucional për hartimin dhe zbatimin e politikave të parandalimit të pastrimit të parave synon më tepër përmbushjen e detyrimeve administrative se sa diskutimin e sfidave dhe përmirësimin e politikave. .

## Dokumentet kyçe të politikave dhe ndërlidhja e tyre

Mungesës së qasjes së qartë institucionale për koordinimin dhe hartimin e politikave të parandalimit të pastrimit të parave i shtohet paqartësia strategjike e trajtimit të këtyre politikave. Politikat e parandalimit të pastrimit të parave janë të shpalosura në dy dokumente kyçe – përkatësisht Strategjia, e cila u përmend më sipër, dhe *Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë*<sup>11</sup> (më tutje “Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar”) i vitit 2020.

Strategjia nuk synon të përcaktojë drejtimin e politikave vetëm për parandalimin e pastrimit të parave (dhe financimin e terrorizmit). Problematika e pastrimit të parave është veçse një prej përparësive në një qasje më të gjerë politike për të luftuar krimin ekonomik në format e tij më problematike, duke përfshirë edhe evazionin fiskal, kontrabandën, mashtrimin dhe ekonominë informale.

Duke qenë se politikat për parandalimin e pastrimit të parave nuk shihen më vete, por si pjesë e një qasje më të gjerë të politikave të formalizimit të ekonomisë dhe luftën ndaj krimit ekonomik, ato nuk marrin vëmendjen e duhur në këtë strategji. Strategjia bën dy ndarje tematike në paraqitjen e sfondit të problemit: (i) ekonomia jo-formale dhe (ii) pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe krimet financiare (PPFTKF). Ekonominë jo-formale e trajton në aspektin e

9 Një kërkesë për qasje në dokumente publike iu dërgua ministrisë së Financave në datën 20 korrik 2023, ku iu kërkua nëse mund të ndante akte rregullatore të të dyja strukturave. Në përgjigjen e saj, ministria e Financave iu referua përcaktimeve në Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023.

10 Informacion i dhënë nga ministria e Financave nëpërmjet postës elektronike në datën 01 gusht 2023 në përgjigje të një kërkesë për qasje në dokumente publike.

11 Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, *Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë* (Prishtinë: Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, 2020), [https://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/02/NRA\\_Final\\_2020\\_Albanian\\_final\\_12-2020.pdf](https://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/02/NRA_Final_2020_Albanian_final_12-2020.pdf).

evazionit fiskal dhe punën në të zezë, duke renditur një sërë shkaqesh dhe pasojash të saj.<sup>12</sup> Strategjia konsideron se nxitja e kriminalitetit, humbjet financiare dhe dëmtimi i komunitetit janë kërcënimet kryesore të lidhura me PPFTKP. Në të njëjtën kohë, ekonomia jo-formale shihet edhe si mundësuese e pastrimit të parave, një proces i cili kryhet në mënyra relativisht të pasofistikuara duke marrë parasysh mundësitë që sjell informaliteti i ekonomisë për një aktivitet të tillë.<sup>13</sup> Kësisoj, Strategjia e ndërthur problematikën e ekonomisë jo-formale me atë të pastrimit të parave në mënyrë të pazgjdhshme. Dhe **pavarësisht ndarjes tematike të shpalosur te pjesa e sfondit të Strategjisë, objektivat strategjikë dhe specifikë nuk janë të ndarë sipas tematikave.** Përkundrazi, **masat që propozohen synojnë në tërësi të formalizojnë ekonominë e nëpërmjet formalizimit të saj dhe përmirësimit të strukturës institucionale të kontrollit financiar të trajtohet edhe disa prej pasojave problematike të ekonomisë jo-formale – përkatësisht pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit.**

Kësisoj, Strategjia e anashkalon konceptualisht mundësinë e pastrimit të parave nëpërmjet bizneseve të ligjshëm dhe duke shfrytëzuar boshllëqe ligjore, ndërkohë masat e propozuara për të trajtuar specifikisht çështje të veprimtarive institucionale për pastrimin e parave i referohen veprimtarive rutinore të cilat kanë pak ose aspak ndikim në parandalimin e pastrimit të parave. Parashikohet – ndër të tjera – “zgjerimi i gamës së vlerësimit të rrezikut nga NJIF duke shtuar vlerësimin e sektorit financiar”<sup>14</sup> dhe “publikimi dhe përditësimi i listës së [vendeve me rrezikshmëri të lartë] (sipas publikimeve të FATF), lista e zezë e BE, lista e OECD<sup>15</sup> për pasaportat e arta”<sup>16</sup>.

Masa e parë është parashikuar t’i shërbejë **objektivit specifik (I.1) për përmirësimin cilësor të të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme për uljen e ekonomisë jo-formale**, ndërsa masa e dytë synon t’i shërbejë **objektivit specifik (I.3) për përmirësimin cilësor të kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.** Përsa i përket masës së parë, është e paqartë nëse i referohet VRK apo vlerësimeve sektoriale. Nëse bëhet fjalë për vlerësimet sektoriale, nuk paraqitet qartë se në ç’drejtimit duhet të përqëndrohet ky vlerësim i kryer nga NJIF, duke qenë se ky proces është së pari përgjegjësi e mbikëqyrësit sektorial – pra Bankës Qendrore të Kosovës në këtë rast. Ndërkohë, masa e dytë është krejtësisht e palidhur me objektivin specifik. **Vetëm**

12 Ndër shkaqet renditen mungesa e ndërgjegjësimit shoqëror, korrupsionin në institucionet publike dhe mungesa e zbatimit të masave të përshtatshme shtrënguese; ndër pasojat e ekonomisë informale renditen cënimi i të drejtave të punëtorëve, deformimi i tregut dhe pamundësia e hartimit të politikave të efektshme ekonomike për shkak të mungesës së të dhënave të sakta.

13 Ministria e Financave, Punës dhe Transferave, *Strategjia Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023*, 13-17.

14 Ministria e Financave, Punës dhe Transferave, *Strategjia Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023*, 21.

15 Organisation for Economic Cooperation and Development.

16 Ministria e Financave, Punës dhe Transferave, *Strategjia Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023*, 23.

**publikimi dhe përditësimi i listave nuk ka asnjë efekt mbi përmirësimin cilësor të kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.**

Politikat e parandalimit të pastrimit të parave trajtohen në mënyrë të ngjashme në Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar të vitit 2020. Dokumenti trajton (i) kërcënime prej pastrimit të parave, (ii) kërcënime prej terrorizmit, (iii) cënueshmëritë në subjektet ekonomike. Pjesa që trajton llojet e kërcënimeve prej pastrimit të parave bën një vlerësim të përgjithshëm të shkallës së rrezikut që vjen mes të tjerash prej evazionit fiskal, mashtrimit apo trafiqueve.<sup>17</sup> Por ai është disi i përgjithshëm dhe nuk identifikon specifikisht mjetet dhe mekanizmat specifike të pastrimit të parave, në mënyrë të atillë që të japë një pamje të qartë të zhvillimit të dinamikave përgjatë tre-katër viteve paraardhëse dhe të skicojë se cilët janë aktorët kryesorë, mjetet dhe mekanizmat e përdorura, boshllëqet e sektorëve kyç që shfrytëzohen, boshllëqet rregullatore, si dhe rreziqet në horizont për shkak të zhvillimeve teknologjike, luftrave apo faktorëve të tjerë rajonal e global. Për më tepër, disa prej statistikave të përdorura për të paraqitur situatën e evazionit fiskal dhe të punësimit në sektorin e ndërtimit janë relativisht të vjetra, prej vitit 2014.<sup>18</sup>

NJIF-K ka publikuar një volum të bollshëm të quajtur *Tipologjitë e Pastrimit të Parave: Kosovë*<sup>19</sup>, ku përfshihen disa shembuj dhe skenarë të mënyrave të pastrimit të parave. Mirëpo është shpesh herë e vështirë të dallohet midis pastrimit të parave nga njëra anë dhe mashtrimit apo evazionit fiskal nga ana tjetër. Ndonëse të dyja janë të ndërlidhura dhe evazoni fiskal apo mashtrimi mund të jenë vepra penale të ndërlidhura me atë të pastrimit të para, është e rëndësishme që të ketë një lloj ndarje për efekte të qartësisë së tipologjive dhe qasjes për trajtimin e tyre. Kësisoj, disa prej tipologjive të cilat parashtrohen në *Tipologjitë e Pastrimit të Parave: Kosovë* ngjasojnë më tepër me shembuj të evazionit fiskal se sa të pastrimit të parave.<sup>20</sup>

Duket se përfshirja e pastrimit të parave në një qasje strategjike ku kjo problematikë shihet kryesisht si pjesë e një problematike më madhore – përkatësisht ajo e krimit ekonomik – ka krijuar disa paqartësi në qasjet e politikave për ta luftuar atë. Ndarja e qartë konceptuale midis pastrimit të parave dhe krimeve të tjera ekonomike shërben për të përcaktuar masa specifike institucionale që synojnë parandalimin e pastrimit të parave, duke i dalluar ato prej masave të tjera që synojnë uljen e informalitetit dhe evazionin fiskal. Sigurisht që ato mund të ndërthuren, por fillimisht është e nevojshme të qartësohen dallimet mes tyre. Sigurisht që pastrimi i parave lehtësohet në një ekonomi joformale, por nuk do të thotë që ajo nuk mund të ndodhë edhe duke shfrytëzuar biznese të ligjshëm. Dhe sa më shumë që Kosova përparon në formalizimin e ekonomisë së saj, aq më tepër do të sofistikohen edhe metodat e pastrimit të parave në të ardhmen nëpërmjet strukturave të ligjshme të biznesit.

17 Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, *Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë*, 14-35.

18 Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, *Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë*, 14, 44.

19 Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, *Tipologjitë e Pastrimit të Parave: Kosovë* (Prishtinë: Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, 2020), [https://fiu.rksgov.net/wpcontent/uploads/2021/07/Tipologjite\\_e\\_PP\\_Alb\\_2020.pdf](https://fiu.rksgov.net/wpcontent/uploads/2021/07/Tipologjite_e_PP_Alb_2020.pdf).

20 Shih Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, *Tipologjitë e Pastrimit të Parave: Kosovë*, 67-68.

# KUADRI RREGULLATOR DHE MBIKËQYRJA

Paqartësitë e qasjes strategjike dhe politike për parandalimin e pastrimit të parave shoqërohen me paqartësi ligjore e institucionale. Kuadri ligjor për parandalimin e pastrimit të parave nuk i ka të mirëpërcaktuara detyrimet dhe kompetencat e institucioneve publike dhe bashkësive profesionale të cilat janë përgjegjëse për marrjen e masave për parandalimin e pastrimit të parave. Në disa raste përgjegjësitë duken sikur janë kolektive e për më tepër mekanizmat institucionale për të koordinuar zbatimin e detyrimeve ligjore që lidhen me mbikëqyrjen, sanksionimin dhe hetimin e veprimtarisë së subjekteve raportuese mungojnë në mjaft raste.

## Përgjegjësitë e mbikëqyrjes

Përgjegjësia parësore për mbikëqyrjen e subjekteve raportuese<sup>21</sup>, pra të bizneseve të cilat janë subjekte të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave, bie mbi **mbikëqyrësit sektorialë**, të cilët janë autoritetet përgjegjëse për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e tyre. Ndërkohë që për disa prej subjekteve raportuese është e qartë se cili është mbikëqyrësi sektorial, për të tjerat nuk është mjaft e qartë pasi ato nuk janë të rregulluara nëpërmjet licencimit të posaçëm prej një autoriteti të caktuar për të zhvilluar aktivitetin e tyre ekonomik, por rregjistrohen thjesht si biznese që nuk kanë nevojë për licenca të veçanta (shih tabelën më poshtë).

**Tabela 2** Mbikëqyrja sektoriale e subjekteve raportuese

SUBJEKTET RAPORTUESE	AUTORITETI LICENCUES / RREGJISTRUES / MBIKËQYRËS	MBIKËQYRËSI SEKTORIAL PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE
Bankat	BQK	BQK
Institucionet financiare jobankare	BQK	BQK
Kazinotë	E pazbatueshme <sup>22</sup>	E pazbatueshme
Agjentët e pasurive të patundshme	Nuk ka	NJIF-K
Tregtarët me vlera të larta në para të gatshme (10000 EUR e sipër)	Nuk ka	NJIF-K

21 Shih nenin 16 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit për listën e subjekteve raportuese.

22 Lojrat e fatit, përfshi edhe kazinotë, janë ndaluar prej prillit 2019, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojrave të Fatit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=19056>.

SUBJEKTET RAPORTUESE	AUTORITETI LICENCUES / RREGJISTRUES / MBIKËQYRËS	MBIKËQYRËSI SEKTORIAL PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE
Avokatët	Oda e Avokatëve	NJIF-K
Noterët	Ministria e Drejtësisë/Oda e Noterëve	NJIF-K
Kontabilistë, auditorë, këshilltarë tatimor	Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar	NJIF-K
Truste	E pazbatueshme	E pazbatueshme
Organizata Joqeveritare (OJQ)	Departamenti për Organizata Joqeveritare	NJIF-K
Shitës të metaleve dhe gurëve të çmuara	Agjencia e Metrologjisë së Kosovës <sup>23</sup>	NJIF-K

**Burimi:** Tabela është hartuar në bazë të shqyrtimit të dispozitave ligjore përkatëse për secilin subjekt raportuese

Shpërndarja e detyrave midis NJIF-K dhe mbikëqyrësve sektorialë nuk është gjithnjë e qartë. NJIF-K ka një rol thelbësor në zbatimin e ligjit. Ajo duhet të nxjerrë akteve nënligjore, udhëzimeve dhe urdhrave për përdorimin e formateve standarde të raportimeve. Gjithashtu merr dhe përpunon raportimet e transaksioneve dhe aktiviteteve të dyshimta; mund të ngrijë përkohësisht transaksionet e dyshimta; si dhe kryen **mbikëqyrjen dhe monitorimin e subjekteve raportuese në lidhje me zbatimin e kuadrit rregullator për parandalimin e pastrimit të parave**.<sup>24</sup>

Pavarësisht këtyre kompetencave të gjera, dispozita të tjera të këtij ligji përmbajnë kufizime ose kushtëzime – sidomos në lidhje me mbikëqyrjen dhe monitorimin e subjekteve raportuese. NJIF-K mund të kryejë inspektime të pajtueshmërisë të çdo subjekti raportues në vend, duke përfshirë edhe bankat dhe institucionet financiare jobankare në bazë të nenit 35; megjithatë, për këto subjekte raportuese **inspektimin në vend mund ta kryejë vetëm për të parë pajtueshmërinë në lidhje me procedurat e vlerësimit të riskut dhe të raportimit të transaksioneve të dyshimta**.<sup>25</sup>

23 Duhet theksuar se Agjencia e Metrologjisë së Kosovës është përgjegjëse për kontrollin e cilësisë së punimeve dhe pastërtisë së metaleve, por nuk ka një autoritet për licencimin e shitësve. Shih Ligjin Nr. 08/L – 029 për Punimet nga Metalet e Çmuara, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2869>.

24 Shih nenin 14 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

25 Shih nenin 35 (3) të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

Neni 34 (4) përcakton BQK si autoritetin mbikëqyrës për bankat dhe institucionet e tjera financiare jobankare, e rrjedhimisht si autoritetin kyç për të nxjerrë udhëzimet e nevojshme për zbatimin e detyrimeve të këtyre institucioneve për parandalimin e pastrimit të parave. Ndërkohë për subjektet e tjera raportuese, neni 34 (5) i kërkon NJIF-K të hyjë me çdo mbikëqyrës sektorial **“në marrëveshje specifike individuale me shkrim me qëllim të krijimit të kompetencës mbikëqyrëse dhe përgjegjësi, procedurave dhe bashkëpunimit përkatës”**.

Pra, ndërkohë që për subjektet e tjera raportuese NJIF-K mund të kryejë inspektive pajtueshmërie të pakufizuar – nëse hyn në një marrëveshje të posaçme me mbikëqyrësin sektorial, në rastin e bankave dhe institucioneve financiare jobankare inspektimet e pajtueshmërisë kryhen kryesisht prej BQK.

Paqartësia e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi mes NJIF-K, BQK dhe mbikëqyrësve sektorialë përshkon edhe dispozitat ligjore të cilat rregullojnë detyrimet e subjekteve raportuese lidhur me kujdesin e duhur ndaj klientit<sup>26</sup>, kujdesin e shtuar ndaj klientit<sup>27</sup>, kujdesin e duhur të thjeshtëzuar<sup>28</sup>, mbajtjen e shënimeve<sup>29</sup>, si dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit<sup>30</sup>.

Përsa i përket **kujdesit të duhur ndaj klientit dhe mbajtjes së shënimeve**, dispozitat ligjore për secilin prej neneve përkatëse përcaktojnë se NJIF-K, BQK apo mbikëqyrësit sektorialë mund të nxjerrin aktet nënligjore, pa e qartësuar kësisoj përgjegjësinë specifike të secilit. Në rastin e **kujdesit të duhur të shtuar ndaj klientit**, neni 22 (1) përcakton se mbikëqyrësit sektorialë mund të nxjerrin udhëzimet përkatëse; ndërsa në rastin e **kujdesit të duhur të thjeshtëzuar**, neni 24 (5) përcakton se NJIF-K mund të nxjerrë udhëzimet përkatëse në bashkëpunim me mbikëqyrësit sektorial dhe neni 24 (6) përcakton se BQK mund të nxjerrë udhëzimet përkatëse për subjektet raportuese nën mbikëqyrjen e saj.

Dispozitat për nxjerrjen e këtyre udhëzimeve kërkojnë që ato të nxirren në përputhje me nenin 66 (2). Në vend që **neni 66 (2)** të shërbente për të qartësuar ndarjen e përgjegjësi dhe mënyrën e bashkëpunimit midis NJIF-K dhe mbikëqyrësve sektorialë, ai në fakt është tejet i përgjithshëm pasi **kërkon që NJIF-K, BQK dhe autoritet mbikëqyrës sektoriale “në çdo kohë në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me njëra tjetrën [të] miratojnë, ndryshojnë apo shfuqizojnë akte nënligjore...për zbatimin e detyrimeve të këtij ligji”**. Kjo dispozitë shpreh më së miri thelbin e paqartësisë së përgjegjësi rregullatore duke mos detajuar natyrën e bashkëpunimit dhe përgjegjësi specifike të tyre.

26 Neni 19 i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

27 Neni 22 i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

28 Neni 23 i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

29 Neni 20 i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

30 Neni 66 i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

## Mangësitë e mekanizmave të mbikëqyrjes

Problematika e mësipërme e lidhur me mungesën shpalesive të përgjegjësive të qarta ligjore me NJIF-K dhe mbikëqyrësve sektorialë dalin në pah edhe nëpërmjet hartimit të udhëzimeve të përgjithshme në disa raste e në raste të tjera me mungesa udhëzimesh për subjektet raportuese mbi veprimet e tyre për parandalimin e pastrimit të parave.

Ndonëse NJIF-K duhet të nënshkruajë marrëveshje me secilin mbikëqyrës sektorial për të ushtruar detyrat e mbikëqyrjes, **nuk rezulton se NJIF-K e kryen mbikëqyrjen e këtyre subjekteve raportuese në bazë të një marrëveshjeje me mbikëqyrësit sektorial të tyre.**<sup>31</sup> Përpos mungesës së marrëveshjeve me mbikëqyrësit e tjerë sektorialë, të cilat do t'i jepnin të drejtën për hartimin e udhëzimeve për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave, udhëzimet e nxjerra prej NJIF-K janë të përgjithshme dhe nuk japin shumë më tepër detaje se dispozitat përkatëse ligjore. NJIF-K ka nxjerë vetëm një udhëzim të posaçëm për rregullat që duhet të ndjekin profesionistët ligjorë<sup>32</sup>, ndërkohë që pjesa tjetër e udhëzimeve – për identifikimin e pronarit përfitues<sup>33</sup> dhe për personat e ekspozuar politikisht (PEP)<sup>34</sup> – janë të përgjithshme duke qenë se nuk përfshijnë dispozita të veçanta për zbatimin e tyre për secilën prej kategorive të subjekteve raportuese. Pra, nuk përfshihen shpjegime të mëtejshme rreth procedurave specifike që duhet të ndjekin llogaritarët, avokatët, agjentët e patundshmërive e kështu me radhë.

Në mënyrë të ngjashme, BQK ka nxjerrë një rregullore të përgjithshme për parandalimin e pastrimit të parave<sup>35</sup>, një udhëzim për identifikimin e pronarëve përfitues<sup>36</sup> dhe një udhëzim për përdorimin e formularit mbi prejardhjen e fondeve dhe përcaktimin e mbajtësit të së drejtës së pronësisë<sup>37</sup>, të cilat janë për t'u zbatuar nga subjektet raportuese banka dhe institucione financiare jobankare. Ndonëse këto rregullore përmbushin teknikisht detyrimin ligjor të BQK për miratimin e akteve nënligjore në dobi të zbatimit të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave, dispozitat e këtyre akteve nënligjore janë të përgjithshme dhe nuk ofrojnë udhëzime të veçanta për veprimtarinë e secilës kategori të subjekteve raportuese – si për bankat ashtu dhe për kategoritë e tjera të institucioneve financiare.

Ndryshe prej akteve nënligjore të mësipërme të hartuara veçmas prej NJIF-K dhe BQK,

31 Në bazë të informacionit të vendosur në dispozicion prej NJIF-K nëpërmjet postës elektronike në datën 18 shtator 2023, në përgjigje të një kërkesë për qasje në dokumente publike, rezultoi se NJIF-K nuk ka nënshkruar marrëveshje me mbikëqyrësit sektorial.

32 Udhëzues (NJIF-K) Nr. 01/2023 për Zbatimin e Detyrimeve për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (PPP/LFT) për Profesionistët Ligjorë.

33 Udhëzim Administrativ MF (NJIF-K) Nr. 01/2021 për Pronarin Përfitues për Subjektet Raportuese.

34 Udhëzim Administrativ MF (NJIF-K) Nr. 02/2018 për Personat e Ekspozuar Politikisht.

35 Banka Qëndrore e Kosovës, *Rregullore për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit*, 30 janar 2020.

36 Banka Qëndrore e Kosovës, *Udhëzim mbi Identifikimin e Pronarëve Përfitues*, 26 dhjetor 2017.

37 Banka Qëndrore e Kosovës, *Udhëzim për Përdorimin e Formularit mbi Prejardhjen e Fondeve dhe Përcaktimin e Mbajtësit të së Drejtës së Pronësisë*, 2 shkurt 2021.

udhëzimi i NJIF-K për mbajtjen e statistikave për parandalimin e pastrimit të parave<sup>38</sup> është hartuar në bashkëpunim me BQK. Megjithatë, në fushëveprimin e këtij akti përfshihen vetëm bankat dhe institucionet financiare jobankare, duke e lënë kështu të parregulluar procedurën për subjektet e tjera raportuese. Është disi e paqartë arsyeja për të cilën NJIF-K dhe BQK i kanë dhënë përparësi rregullimit të procedurave për mbajtjen e statistikave vetëm për bankat dhe institucionet financiare jobankare, ndërkohë që dispozita përkatëse e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave e përcakton qartë se jo vetëm bankat dhe institucionet financiare jobankare, por edhe **“subjektet raportuese si dhe personat ose subjektet e tjera që kanë detyrime ose funksione sipas këtij ligji mbajnë të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse përkatëse për fushën e tyre të përgjegjësisë”**<sup>39</sup>.

Duket se ligji efektivisht ka caktuar NJIF-K dhe BQK si dy autoritetet kryesore rregullatore për politikën e pastrimit të parave, duke lënë të pacaktuara përgjegjësitë e mbikëqyrjes sektoriale që duhet të bartnin autoritetet licencuese të subjekteve të tjera raportuese. **Ligji përmend vetëm njëherë Odën e Avokatëve, Odën e Noterëve dhe Këshillin e Kosovës për Raportimin Financiar (KKRP) në lidhje me përgjegjësinë që ato kanë për të informuar avokatët, noterët, kontabilistët, auditorët dhe këshilltarët tatimor mbi detyrimet për të raportuar sipas parashikimeve të nenit 31, por nuk përcakton përgjegjësi të tjera mbikëqyrëse për to.** Ndonëse përcaktimi i saktë i mbikëqyrësit sektorial për secilën kategori të subjekteve raportuese është edhe më i domosdoshëm për shkak se ligjet që rregullojnë licencimin e këtyre subjekteve nuk përmbajnë dispozita që trajtojnë detyrimet që duhet të kenë autoritetet licencuese për parandalimin e pastrimit të parave, Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave nuk shkon tutje përmendjes së odave dhe të KKRPs.

Përzierjet dhe paqartësitë e detyrimeve institucionale të NJIF-K dhe mbikëqyrësve sektorialë kanë bërë që në disa raste detyrat për miratimin e akteve nënligjore të dyfishohen, si për shembull nxjerrja e dy akteve nënligjore për identifikimin e pronarëve përfitues – një prej NJIF-K dhe një tjetër prej BQK. Ndërkohë në rastin e udhëzimit për mbajtjen e statistikave, subjektet raportuese që nuk janë banka apo institucionet financiare jobankare janë harruar. Për më tepër **zbatimi rigoroz i dispozitave të parandalimit të pastrimit të parave bëhet edhe më i vështirë për subjektet raportuese kur ato nuk kanë qasje në një bazë të dhënash për personat e ekspozuar politikisht dhe për pronarët përfitues.** Këto nuk janë thjesht mangësi administrative, por tregues të nevojës thelbësore për të përmirësuar kuadrin rregullator dhe mekanizmat e bashkëpunimit.

38 Udhëzim Administrativ MF (NJIF-K) Nr. 01/2018 për Mbajtjen e Statistikave për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

39 Shih nenin 39 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave.

# ZBATIMI I MASAVE PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE

Raportet vjetore të NJIF-K dhe të BQK për koordinimin dhe mbikëqyrjen e politikave për parandalimin e pastrimit të parave ofrojnë pak të dhëna dhe informacione. Megjithatë, informacioni i publikuar, duke përfshirë edhe raportet vjetore të progresit për Kosovën nga Komisioni Evropian<sup>40</sup>, tregojnë për njëfarë progresi relativ në tri vitet e fundit në drejtim të shkëmbimit të të dhënave dhe bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese, ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe vendosjes së rregullave bazë të raportimit. Ajo çka mungon – si nga raportet e institucioneve të Kosovës, ashtu edhe prej raporteve vjetore të Komisionit Evropian – është trajtimi i problematikave që lidhen me koordinimin institucional të politikave, kapacitetet institucionale, si dhe hetimet dhe ndëshkimet ndaj shkelësve të dispozitave të legjislacionit të parandalimit të pastrimit të parave.

Gjatë viteve 2019-2021, NJIF-K ka kryer nga 25 deri në 31 inspektime pajtueshmërie, të cilat janë përqëndruar kryesisht në subjektet noterë, auditorë/kontabilistë, autosallone e më pak në banka (shih Tabelën 2).<sup>41</sup> Ndërkohë që në vitet 2019 dhe 2021 NJIF-K ka dhënë respektivisht 102 dhe 130 rekomandime për masa përmirësuese, masat ndëshkimore për vitin 2021 kanë qenë më të ulëtat dhe gjatë periudhës 2019-2021 nuk i kanë kaluar tetë masa (në total 900,000 EUR). Në periudhën 2020-2021 një pjesë e mirë e inspektimeve janë kryer në distancë për shkak të pandemisë COVID-19. Duke marrë parasysh këto vështirësi, vijimi i inspektimeve dhe dhënia e rekomandimeve janë zhvillime pozitive; megjithatë **ka një mangësi të dukshme të inspektimeve të pajtueshmërisë për avokatët, agjencitë e patundshmërisë, agjencitë e transferimit të parave, tregtarët me vlera të mëdha në para të gatshme, si dhe tregtarët e metaleve të çmuara**. Mungesa e udhëzimeve përkatëse për këto kategori subjektsh raportuese, së bashku me mungesat e inspektimeve ndaj tyre, i bën ato tejet të çënueshme ndaj rreziqeve për t'u përdorur si mekanizma për pastrimin e parave.

**Tabela 3** Tregues të zbatimit të masave për parandalimin e pastrimit të parave (2019-2021)

TREGUES	2019	2020	2021
Raporte të transaksioneve të dyshimta (PP)	997	896	914

40 Raportet e progresit për Kosovën mund të gjenden në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/kosovo\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/kosovo_en).

41 Shih raportet vjetore të NJIF-K, të cilat mund të gjenden në: [https://fiu.rks-gov.net/publications/#section\\_1](https://fiu.rks-gov.net/publications/#section_1).

TREGUES	2019	2020	2021
Urdhra ngrirjeje	3	31	46
Vlera e transaksioneve te ngrira	151,000 EUR	1,093,643 EUR	8,975,202 EUR
Raporte te trasaksioneve me para te gatshme	2633	2575	1776
Inspektime pajtueshmerie te NJIF-K	17 notere	19 auditore/ kontabiliste	24 notere
	3 banka	10 autosallone	2 banka; 1 institucion mikrofinanciar
	3 kompani sigurimi	1 banke	2 kembimore
	1 institucion mikrofinanciar	1 agjenci e transferimit te parave	2 auditore/ kontabiliste
	1 agjenci e transferimit te parave		
Rekomandime per masa permiresuese te NJIF-K	102	41	130
Ndeshkime administrative te NJIF-K	3 (1 banke, 1 kompani sigurimesh, 1 noter)	8 (1 banke, 7 autosallone)	1 (banke)
Vlera e ndeshkimeve	330,000 EUR	900,000 EUR	10,000 EUR
Inspektime (ekzaminime) pajtueshmerie te BQK	7	6	8
Hetime	9 persona	33 persona	9 persona
Denime	0	3 persona	1 person
Sekuestrime			
Konfiskime			

**Burimi:** (1) Të dhënat për hetimet dhe dënimet janë marrë prej raporteve të progresit për Kosovën të Komisionit Evropian; (2) të dhënat e tjera janë marrë prej raporteve vjetore të Njesisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës; (3) të dhënat për vendimet e sekuestrimeve dhe konfiskimeve të publikuara paraqesin numrin e përgjithshëm të tyre, ndërkohë që nuk është i qartë numri i vendimet specifike për raste të parandalimit të pastrimit të parave.

Në raportin e vitit 2019, NJIF-K ka përfshirë një tabelë mjaft të dobishme, e cila tregon numrin e raporteve të transaksioneve të dyshimta të ndara në bazë të indikatorëve për përcaktimin e aktivitetit financiar si të dyshimtë.<sup>42</sup> Kjo praktikë e mirë nuk vërehet edhe në raportet vjetore të mëtejshme të NJIF-K. Përgjithësisht, statistikat e **raporteve vjetore të NJIF-K** pas vitit 2019 për raportet e transaksioneve të dyshimta nuk janë mjaftueshëm të detajuara. Të dhënat për transaksionet e dyshimta përfshijnë kategoritë e subjekteve raportuese, por nuk përfshijnë gjithashtu llojet e aktiviteteve të dyshimta të cilat janë kategorizuar si të tilla. Nga ana tjetër, statistikat për urdhrat e ngrirjeve të transaksioneve përmbajnë edhe më pak informacion se sa raportet e transaksioneve të dyshimta. Ato nuk janë të ndara sipas llojeve të subjekteve, aktiviteteve ekonomike dhe arsyeve të kategorizimit të transaksioneve si të dyshimta, të cilat kanë çuar në lëshimin e një urdhri ngrirjeje, por përmbajnë vetëm numrin e vendimeve të lëshuara për secilin vit dhe vlerën monetare të transaksioneve.<sup>43</sup>

**Raportet vjetore të BQK** përfshijnë një pjesë të shkurtër që përmbledh aktivitetet e Bankës si mbikëqyrës sektorial. Këto raporte, ndryshe prej atyre të NJIF-K, nuk përmbajnë statistika të ndara për të kuptuar veprimtarinë mbikëqyrëse të BQK. Ato përmbajnë vetëm numrin e ekzaminimeve (inspektimeve) të plota – pra tërësore – dhe atyre të përqëndruara (kufizuara), të cilat janë tematike në natyrë. Për vitet 2019-2021, BQK nuk ka kryer mesatarisht më tepër se tetë ekzaminime në sektorin financiar për një vit. Përpos numrit tejet të ulët, nuk ka të dhëna rreth numrit të rekomandimeve apo masave administrative ndëshkuese ndaj subjekteve raportuese të marra prej BQK.<sup>44</sup>

Nga ana tjetër, rritja e urdhrave për ngrirjen e transaksioneve të lëshuara nga NJIF-K – nga tre në 2019 deri në 46 në 2021 – është një prirje pozitive dhe vlen për t'u theksuar se pjesa dërrmuese e urdhrave – 38 syresh – kanë ardhur si pasojë e punës analitike të kryer nga NJIF-K, së bashku me institucionet e tjera ligjzbatuese.<sup>45</sup> Por **numri i urdhrave të ngrirjes së transaksioneve mbetet ende i ulët në rapor me numrin e transaksioneve të dyshimta**. E njëjta prirje vihet re lidhur me raportin midis masave ndëshkimore dhe numrit të inspektimeve të mbikëqyrjes së NJIF-K. Sigurisht që rekomandimet për masa përmirësuese janë të preferueshme nëse janë

42 Llojet e veprimtarive të cilat janë raportuar si transaksione të dyshimta përfshijnë, për shembull, blerjen e aseteve me vlerë të lartë, evasion fiskal, transferet e shumëfishta të fondeve të cilat duket se kanë lidhje me përfituesit e përbashkët. Shih Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, *Raporti Vjetor 2019* (Prishtinë: 2020), 21, [https://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/01/NJIF-K\\_Raporti\\_Vjetor\\_2019.pdf](https://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/01/NJIF-K_Raporti_Vjetor_2019.pdf).

43 Shih për shembull, Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, *Raporti Vjetor 2021* (Prishtinë: 2022), 27, [https://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/09/NJIF-K\\_Raporti\\_Vjetor\\_2021.pdf](https://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/09/NJIF-K_Raporti_Vjetor_2021.pdf).

44 Raportet vjetore të Bankës Qëndrore të Kosovës mund të gjenden në: <https://bqk-kos.org/publikimet/raporti-vjetor-i-bqk-se/>.

45 Informacionit i dhënë prej NJIF-K në datën 18 shtator 2023 nëpërmjet postës elektronike, në përgjigje të një kërkese për qasje në dokumente zyrtare.

të efektshme për të siguruar pajtueshmërinë e subjekteve raportuese, sidomos duke marrë parasysh nevojën për rritjen e kapaciteteve të tyre raportuese, por në të njëjtën kohë duhet të ketë edhe ndëshkime për t'i ndërgjegjësuar subjektet raportuese për detyrimet e tyre ligjore dhe ndikimin që kanë masat që duhet të marrin në drejtim të parandalimit të pastrimit të parave.<sup>46</sup>

Një mangësi thelbësore si në raportimet e NJIF-K ashtu dhe të raporteve të zbatimit të Strategjisë<sup>47</sup> janë të dhënat e pandërthurura e të paplota me efektshmërinë e zbatimit të politikave të parandalimit të pastrimit të parave. Ndërkohë që raportimet e NJIF-K përmbajnë të dhëna rreth veprimtarisë së institucionit dhe subjekteve raportuese, ato nuk paraqesin të dhëna mbi hetimet e kryera dhe rezultatet e tyre. Raportet e Strategjisë kanë të përmbledhura në baza vjetore numrin e veprave penale, numrin e personave dhe numrin e veprimeve/vendimeve të marra në total për rastet e pastrimit të parave, por pa shprehur konkretisht llojet e veprimeve/vendimeve të marra.<sup>48</sup>

Vlerësimi i rezultateve të masave për të parandaluar pastrimin e parave mund të kryhen duke u bazuar në të dhëna të qarta mbi numrin e hetimeve, sekuestrimeve, konfiskimeve dhe dënimeve si rezultate të punës së kryer prej NJIF-K, Policisë së Kosovës, Prokurorisë së Shtetit dhe gjykatave. Aktualisht nuk ka të publikuar një databazë të plotë ku të shihen qartë e të bëhet një analizë e numrit të urdhrave të ngrirjes së transaksioneve, numrit të hetimeve për raste të pastrimit të parave, vendimet e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive dhe mjeteve monetare, si dhe vendimet për masat ndëshkuese. Për më tepër, nuk duket se ka një institucion të caktuar për të grumbulluara dhe të sistematizuara këto të dhëna. NJIF-K, për shembull, nuk kryhen një gjurmim sistematik të ecurisë dhe përfundimeve të hetimeve që kryhen pas lëshimit të urdhrave të ngrirjes së transaksioneve.<sup>49</sup> Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) **nuk ka të dhëna specifike për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara në raste të hetimeve për pastrimin e parave.**<sup>50</sup> Ndërkohë të dhënat e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik paraqesin numrin e rasteve, personave dhe të aktakuzave apo të vendimeve për pushime hetimore të marra prej Prokurorisë Speciale. Ato nuk përmendin më tutje rezultatet e procesit gjyqësor dhe as nuk bëjnë një analizë të problematikave të veçanta

46 Gjatë hulumtimit për këtë punim u kontaktuan përfaqësuesit e Odës së Avokatëve, Odës së Noterëve dhe të Shoqatës së Bankave. Përveç Shoqatës së Bankave, dy bashkësitë e tjera profesionale nuk shprehën interes për të diskutuar rreth rolit të tyre në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave. Sipas njërës prej përfaqësuesve të njërës prej dy bashkësive profesionale, me të cilin u zhvillua një bisedë telefonike në datën 7 shtator 2023, janë institucionet publike ato të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionin e parandalimit të pastrimit të parave dhe jo bashkësia profesionale e përfaqësuar prej tij.

47 Raportet e zbatimit të Strategjisë mund të gjenden në: <https://mfpt.rks-gov.net/Page/597>.

48 Shih për shembull, Ministria e Financave, Punës dhe Transferave, Annual Report 2021-2022 on the Implementation of the National Strategy of the Republic of Kosovo for the Prevention and Combatting of Informal Economy, Money Laundering, Financing of Terrorism, and Financial Crimes. 2019-2023 (Prishtina: Ministry of Finance, Labour and Transfers, 2023), 25.

49 Në bazë të informacionit të vendosur në dispozicion prej NJIF-K nëpërmjet postës elektronike në datën 18 shtator 2023, në përgjigje të një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, "sistemi i informative kthyes me disa institucione nuk është ende në funksion të plotë".

50 Raportet vjetore të AAPSK mund të gjenden në: <https://aapsk.rks-gov.net/raportet/>.

teknike apo tipologjinë që mund të paraqesin rastet e shqyrtuara prej Prokurorisë Speciale.<sup>51</sup>

Një tjetër boshllëk për parandalimin e pastrimit të parave është mungesa e bashkëpunimit të ngushtë mes autoriteteve të Kosovës dhe atyre të huaja për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive në raste të hetimeve për pastrimin e parave. Gjatë viteve 2019-2022 ka patur më tepër kërkesa për sekuestrim prej vendeve të huaja ndaj autoriteteve të Kosovës se sa prej Kosovës drejt autoriteteve të huaj, ndërkohë që nuk ka patur kërkesa për konfiskim nga asnjëra palë.<sup>52</sup>

Kosova e realizon bashkëpunimin e saj ndërkombëtar në bazë të Ligjit Nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale. Ligji Nr. 04/L-213 ka vetëm dy nene<sup>53</sup> që trajtojnë kërkesat për kontroll, ngrirje dhe konfiskim dhe nuk përcaktojnë në detaje se cilat duhet të jenë përgjegjësitë dhe procedurat që duhet të ndjekin institucionet e Kosovës për të dërguar drejt autoriteteve të huaja apo për të përpunuar kërkesat e ardhura prej tyre, si dhe situatat në të cilat kërkesa prej një autoriteti të huaj nuk mund të ekzekutohet. Duket se kur hasen boshllëqe, ligji, në qëllimin e tij, i referohet marrëveshjeve që Kosova mund të nënshkruaj me vende të tjera për ndihmë të ndërsjelltë juridike, duke parashtruar se “...ligji rregullon kushtet dhe procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale mes Republikës së Kosovës dhe shteteve të tjera, në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare [theksimi i shtuar]”<sup>54</sup>. Në vend që zbatimi i ligjit të kushtëzohej prej marrëveshjeve ndërkombëtare që lidh Republika e Kosovës, qëllimi i tij do duhej të ishte të vendoste parimet bazë mbi të cilat duhet të lidhen marrëveshjet për ndihmë juridike të ndërsjelltë dhe për bashkëpunime të tjera ndërkombëtare në çështje penale. Për më tepër, marrëveshjet dypalëshe për ndihmë juridike të ndërsjelltë i referohen legjislacionit vendor për të përcaktuar veprimet që duhet të kryhej secili shtet.<sup>55</sup> Kështu që është e domosdoshme që legjislacioni vendor të jetë i qartë e specifik në përcaktimin e përgjegjësive institucionale, dispozitave kufizuese, kostove administrative dhe kompensimin e viktimave kur bëhet fjalë për zbatimin e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim.

51 Shih për shembull Këshilli Prokurorial i Kosovës, *Raport Tremujor (Tetor-Dhjetor 2020) për Aktivitetin dhe Rekomandimet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik* (Prishtinë: Këshilli Prokurorial i Kosovës, 2021), 31.

52 Informacion i dhënë prej ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet postës elektronike në datën 21 shtator 2023 në përgjigje të një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Ministria e Drejtësisë nuk mund të konfirmonte numrin e saktë të kërkesave të ardhura prej autoriteteve të huaja dhe të atyre të dërguara prej autoriteteve të Kosovës.

53 Shih nenet 90-91 të Ligjit Nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale.

54 Neni 1 (1) i Ligjit Nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale.

55 Neni 14, Marrëveshja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë për Ndhimë të Ndërsjelltë Juridike, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=75995>.

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Pavarësisht përparimeve të arritura si rrjedhojë e rritjes së bashkëpunimit mes institucioneve të Kosovës dhe institucioneve ndërkombëtare të cilat ofrojnë ndihmë teknike për parandalimin e pastrimit të parave, duket se qasja strategjike, kuadri rregullator dhe koordinimi ndërinstytucional mes institucioneve të Kosovës mund të përmirësohen më tej.

Përpjekjet për parandalimi i pastrimit të parave janë parë në kuadrin e përgjithshëm të luftës ndaj krimit ekonomik, të ndërthurura kështu me çështje të tjera të cilat lidhen me formalizimin e ekonomisë nëpërmjet rregjistrimit të bizneseve dhe vendosjes së një infrastrukture të efektshme për taksimin e tyre. Mirëpo kjo qasje nuk i jep vëmendjen e duhur nevojave specifike për parandalimit të pastrimit të parave, të cilat janë të pranishme pavarësisht formalizimit më të lartë të ekonomisë, si në aspektin konceptual ashtu edhe në atë institucional.

Duke qenë se Strategjia ka vendosur një kornizë konceptuale që e trajton parandalimin e pastrimit të parave nën suazën e gjerë të politikave të luftës ndaj krimit ekonomik, koordinimi ndërinstytucional për të trajtuar çështjet e parandalimit të pastrimit të parave bëhet i vështirë për shkak të përparësive strategjike të cilat lidhen kryesisht me formalizimin e ekonomisë dhe për shkak të vështirësive të koordinimit të një strategjie e cila ndërthur çështje të fiskalizimit të ekonomisë me ato të sigurisë kombëtare dhe korrupsionit. Rrjedhimisht probleme që lidhen me prodhimin dhe shkëmbimin e të dhënave, koordinimin ndërinstytucional të politikave, boshllëqet e kuadrit rregullator, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave të parandalimit të pastrimit të parave mbeten të patrajuara sistematikisht.

Një problem tjetër që vihet re është se shoqëria civile nuk është mjaft e përfshirë në procesin e hartimit të këtyre politikave dhe dokumentet të cilat janë pjesë integrale të procesit të hartimit të tyre –veçanërisht dokumentet e politikave të hartuara nga institucionet ndërkombëtare –nuk janë të hapura ndaj publikut. Kjo mungesë informacioni e cungon thelbësisht aftësinë e hulumtuesve të pavarur, medias, si dhe organizatave të shoqërisë civile për t'u përfshirë në procesin e politikëbërjes dhe për të ofruar rekomandime për politikëbërësit të bazuar në njohuritë dhe ekspertizën e tyre.

Për të rritur efektshmërinë dhe transparencën e politikave të parandalimit të pastrimit të parave, institucionet e Kosovës të angazhuara në hartimin dhe zbatimin e këtyre politikave mund të marrin parasysh rekomandimet e mëposhtme:

1. Për të patur vëmendjen dhe burimet e duhura institucionale, do të ishte e udhës që politikat e parandalimit të pastrimit të parave të konceptoheshin ndaras prej problemeve më të gjera të krimit ekonomik. Ndonëse pastrimi i parave një lloj i krimit ekonomik, ai është më tepër se kaq. Shpesh herë ky aktivitet është i lidhur me aktivitete të tjera kriminale dhe me korrupsion të nivelit të lartë. Rrjedhimisht kapacitetet institucionale dhe politikat që nevojiten për gjurmimin, hetimin dhe ndëshkimin e kësaj veprimtarie janë teknikisht specifike dhe kërkojnë aftësi dhe vëmendje institucionale të posaçme.
2. Për të parandaluar mbivendosje apo dyfishime detyrash dhe përgjegjësish, do të ishte e

nevojshme të vendosej një ndarje e qartë e përgjegjësive mes strukturave koordinuese ndërinstucionale – pra të Bordit Mbikëqyrës të NJIF-K, Grupit Qeveritar të Punës dhe Sekretariatit. Kjo ndarje do të ndihmonte gjithashtu në vendosjen e mekanizmave të qarta të shkëmbimit të informacionit dhe monitorimit të zbatimit të politikave.

3. Kuadri ligjor për parandalimin e pastrimit të parave do të duhej të rishikohej dhe amendohej prej Kuvendit për të përcaktuar qartë detyrimet e NJIF-K dhe të mbikëqyrësve sektorialë. Në të njëjtën kohë do të duhej që aktet nënligjore të rishikoheshin e të përmirësoheshin prej NJIF-K dhe mbikëqyrësve sektorialë duke përfshirë udhëzime specifike për secilën prej kategorive të subjekteve raportuese.
4. NJIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorialë duhet të ndërmarrin një rol më proaktiv në rregullimin, inspektimin dhe sanksionimin e subjekteve raportuese në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi për përgjegjësitë dhe detyrimet ligjore të tyre. Rritjen e ndërgjegjësimit do ta ndihmonte gjithashtu edhe zgjerimi i kuadrit rregullator duke përfshirë dispozita specifike për çdo kategori të subjekteve raportuese. Duke qenë se mbikëqyrësit sektorialë – përveç BQK – nuk e kanë qenë të angazhuar në rolet e tyre, do të ishte e nevojshme që të merrnin trajnimin e domosdoshëm ligjor e tematik për përmbushjen e detyrimeve të tyre rregullatore.
5. Institucionet përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave të pastrimit të parave duhet të ndërtojnë një bazë të dhënash e cila të përmbajë të dhëna të plota të hetimeve, masave ndëshkuese dhe vendimeve të gjykatës. Kjo bazë të dhënash do t'i shërbente vetë institucioneve për të kryer analiza të ndikimit të politikave të tyre, si dhe publikut për të shqyrtuar ecurinë dhe ndikimin e tyre.
6. Institucionet përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave të pastrimit të parave duhet t'i kushtojnë një vëmendje më të shtuar disa subjekteve raportuese me risk të lartë si noterët, agjentët e patundshmërisë, tregtarët e metaleve të çmuara, tregtarët e veprave të artit, si dhe personat fizikë e juridikë që kryejnë transaksione me para të gatshme në vlerë prej 10,000 EUR ose më shumë. Vëmendja e shtuar nënkupton përcaktimin e qartë të detyrimeve të këtyre subjekteve raportuese, identifikimi i tyre, kryerja e inspektimeve të shpeshta, si dhe rritja e bashkëpunimit ndërinstucional për të shkëmbyer të dhëna rreth aktiviteteve të tyre dhe për të parandaluar përdorimin e tyre si mekanizma për pastrimin e parave.
7. Për të përmirësuar identifikimin e pronarëve përfitues dhe gjurmimin e transaksioneve dhe veprimtarive të tjera financiare të personave të ekspozuar politikisht, do të ishte e dobishme krijimi i bazave të të dhënave për rregjistrimin e informacioneve të nevojshme për këto dy kategori. Informacioni i grumbulluar do t'i shërbente NJIF-K dhe strukturave ligjzbatuese dhe do ta lehtësonte për subjektet raportuese pajtueshmërinë e tyre me dispozitat rregullatore për parandalimin e pastrimit të parave.
8. Për të përmirësuar bashkëpunimin ndërkombëtar, Kuvendi do të duhet të amendojë Ligjin Nr. 04/L-213. Ndër të tjera, në ligj duhet të përcaktohen qartë përgjegjësitë institucionave dhe procedurat e trajtimit të kërkesave për kontroll, ngrirje dhe konfiskim të llogarive bankare dhe pasurive të tjera të shtetasve të Kosovës dhe të vendeve me të cilat lidhen marrëveshje për ndihmë të ndërsjelltë juridike.

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

338.2(496.51)(062)

Rishikim paraprak i zbatimit të politikave për parandalimin e pastrimit të parave në Kosovë : cilat janë sfidat kyçe të hartimit dhe zbatimit të tyre? / QKSS. - Prishtinë : QKSS, 2024. - 26 f. : ilustr. ; 26 cm

**ISBN 978-9951-842-28-0**



**QKSS**  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

## Rreth QKSS

E themeluar në prill të vitit 2008, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është një organizatë e specializuar dhe e pavarur joqeveritare. Qëllimi primar i QKSS është të promovojë demokratizimin e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe të përmirësojë punën kërkimore dhe avokuese në lidhje me sigurinë, sundimin e ligjit dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë.

QKSS synon të rrisë efektivitetin e Reformës së Sektorit të Sigurisë duke mbështetur programet e këtij sektori përmes hulumtimeve, eventeve, trajnimeve, avokimit dhe këshillave të drejtpërdrejta për politikë-bërësit.

Avancimi i ideve të reja dhe metodave të shkencave sociale janë gjithashtu vlerat thelbësore të qendrës. Çdo vit, QKSS publikon raporte të shumta, analiza të politikave dhe përmbledhje të politikave për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë. QKSS gjithashtu organizon më shumë se 200 ngjarje publike duke përfshirë konferenca, tryeza dhe debate, ligjërata në Kosovë, ku një pjesë e tyre organizohen në bashkëpunim me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë.

Një gamë e gjerë aktiviteteve përfshijnë hulumtimin, ngritjen e kapaciteteve, ngritjen e ndërgjegjësimit dhe avokimin. Puna e QKSS-së mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë por pa u kufizuar në: reformën dhe zhvillimin e sektorit të sigurisë, identifikimin dhe analizimin e rreziqeve të sigurisë që lidhen me ekstremizmin, radikalizmin dhe krimin e organizuar, politikën e jashtme dhe bashkëpunimi rajonal, dhe vlerësimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Këtë vit QKSS shënoi 16 vjetorin e themelimit. Për më tepër detaje rreth QKSS, ju lutem na ndiqni në rrjetet tona sociale:



[www.qkss.org](http://www.qkss.org)

[www.securitybarometer.qkss.org](http://www.securitybarometer.qkss.org)



@KCSSQKSS

ISBN 978-9951-842-28-0



9 789951 842280